

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE  
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik X

**Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit**

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomike)*

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)  
"DIAL-ALB" SHPK

Nuis/Nipt  
L41507011N

Adresa:

Tirane Rruga Vore-Rinas, Tirana Industrial Park, Zona Kadastrale Nr. 2105, Nr. i pasurise  
1155/8/ND6-N2

Tirane

Shqiperi

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar / Posta

0699699995

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

info@dialalb.al a.kola@dialalb.al

E-mail

Alba KOLA (Administrator)

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2023/07/06

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0699699995

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)



## Seksioni II. Informacion mbi procedurën

### 1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.  
Nr. REFERENCE: REF-73999-06-30-2023

### 2. Lloji i Procedurës

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.

Procedurë e hapur	<input type="checkbox"/>	<b>Procedurë e hapur e thjeshtuar</b>	<input checked="" type="checkbox"/>
Procedurë e kufizuar	<input type="checkbox"/>	Procedurë konkurruese me negociim	<input type="checkbox"/>
Partneritet për inovacion	<input type="checkbox"/>	Dialog konkurrues	<input type="checkbox"/>
Procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit	<input type="checkbox"/>	Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	<input type="checkbox"/>
Shërbim Konsulence	<input type="checkbox"/>		
Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP	<input type="checkbox"/>		

### 3. Autoriteti /Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

**Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokaster**

### 4. Vlera e përllogaritur e prokurimit

(Vlera e përllogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)

**8,085,990 (tetë milion e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) Leke pa TVSH**

### 5. Objekti i kontratës/Marreveshjes Kuadër

(Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marreveshje kuader).

**“Mirembajtja e pajisjeve të medha mjekesore “full risk”, Marreveshje kuader me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të percaktuara- me afat 2 vjecar (24 muaj)”**

### 6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

(Data (viti/muaji/dita)

**13.07.2023 Ora: 12:00**

### 7. Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)



## 8. Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

## Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

- Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik"
- VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

## 2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

X

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

## 3. Rrethanat dhe faktet

Shoqëria jone "DIAL-ALB" Shpk, me nipt: L41507011N, me date 03.07.2023 është njohur nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me faqen zyrtare te Agjencise se Prokurimit Publik (APP) me proceduren e prokurimit te publikuar nga AK - Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokaster me te dhenat e meposhtme:

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokaster



**Objekti:** "Mirembajtja e pajisjeve te medha mjekesore "full risk", Marreveshje kuader me nje operator ekonomik, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara- me afat 2 vjecar (24 muaj)"

**Nr. References:** REF-73999-06-30-2023

**Lloji i procedures:** E hapur e thjeshtuar, sherbime

**Fondi limit:** 8,085,990 (tetë milion e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) Leke pa TVSH

**Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:** 13.07.2023 Ora: 12:00

**Data e publikimit ne SPE:** 03.07.2023 12:00

Pasi publikimit ne SPE jemi njohur me dokumentet e tenderit per kete procedure prokurimi ku ne permbajtjen e tyre jane parashikuar nga AK kriteret kualifikuese, specifikimet teknike, grafiku i sherbimit dhe termat e references.

Shoqeria jone si operator ekonomik i interesuar per kete procedure prokurimi u konstatua qe ne DST jane parashikuar disa kriteret diskriminuese dhe jo te lidhura ngushtesisht me objektin e prokurimit per kete procedure prokurimi, konkretisht si me poshte:

Ne DST e publikuara ne kriteret e vecanta te kualifikimit ne lidhje me "Kapacitetin Teknik" pika 2.3.3 eshte parashikuar:

*2.3.3 Operatori ekonomik duhet te kete te pakten nje inxhinier per mirembajtjen e sistemit operativ windows ne nivel MCSE ose ekuivalent te aparatures objekt te ketij prokurimi me profil inxhinier biomjekesor/elektronik/*

*Per kete OE duhet te disponoje dokumentat e meposhtme provuese per secilin nga stafi me sipër;*

*-CV-ne e specialistit/ve*

*-Certifikata /deshmite e trajnimit per pajisjen objekt prokurimi, leshur nga kompania prodhuese*

*-Kontrate pune/sherbimi e vlefshme*

*-Listepagesa ku te figurojne emrat e inxhinierve te deklaruar qe nga periudha Shkurt 2023*

Kriteri i mesiperme i vendosur nga ana e AK eshte kriter diskriminues dhe jo ne perputhje me objektin e prokurimit, konkretisht po japim argumente tona si me poshte vijon:

Kriteri e mesiperme sa i takon qe OE duhet te kete te pakten nje inxhinier per mirembajtjen e sistemit operativ windows ne nivel MCSE nuk ka te bejne me mirembajtjen e aparatures si nga ana teknike po ashtu dhe kopjuterike. Mirembajtja e sistemit operativ ne nivel windows eshte e pa nevojshem dhe e tepert pasi sistemet operative per skanerat jane perfshira ne trajnimet e prodhuesit dhe ne asnje rast prodhuesi i aparatures leshon certifikata te tilla. Certifikata te tilla perdoren vetem per kompanite te cilat merren me mirembajtje serverash ne nivel windows dhe per kompani ne sektorin e IT. Per aparaturat mjekesore software provider eshte vetem prodhuesi i paisjes dhe nuk ka nevojte per certifikata nga pale te treta si ajo e microsoft. Nese kjo certifikate do te ishte nevojshme atehere prodhuesi i pajisjes do ta bente te detyrueshme per stafin inxhinierik i cili merret me mirembajtje dhe jo me RD-reserch & Development.

Kjo lloj certifikate ka per qellim zgjidhjen ne infrastrukture dhe network pra ne IT e cila eshte ne kundeshtim me objektin e tenderit. Mirembajtja e pajisjeve spitalore nuk kane te nevojshme certifikaten Microsoft MCSE.

Duke para rendesine e ketij objekti prokurimi sic eshte mirembajtja e pajisjes mjekesore, Mirembajtje Full Risk e pajisjes Skaner per Spitalin Gjirokastër Toshiba/TSX-021B/4, e cila eshte nje pajisje e rendesise se vecante per diagnostikimin dhe trajtimin e pacienteve e cila sherben per qellimin e destinuar duke u sherbyer paciente ne te gjithë Qarkun e Gjirokastres dhe objekti i ketij



prokurimi duhet te jete ne perputhje dhe ne harmoni te plote me kerkesat per kualifikim te parashikuar ne DST me specififikimet teknike dhe termat e references.

Ne specififikimet teknike ne Formularin e sherbime dhe termat e references jane parashikuar sherbimet qe do ti kryhen kesaj pajisje si me poshte:

➤ SPECIFIKIMET TEKNIKE

**Shërbimet që duhet të ofrohen:**

*Mirëmbajtja parandaluese: ky shërbim duhet të kryhet sipas rekomandimeve të prodhuesit, për të parandaluar defektet që lidhen me përdorimin e pajisjeve dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur sistemin e pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të çdo pajisjeje, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetrimi apo përkeqësimi i performancës së pajisjeve.*

*Mirëmbajtja korigjuese: Ky shërbim do të përfshijë përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionim, në identifikimin e shkaqeve, në eliminimin e shkaqeve dhe defekteve dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, në verifikimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe në kontrollin e sigurisë sipas rekomandimeve te prodhuesit. Ky shërbim do të përfshijë edhe lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin e pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes dhe kalibrimit.*

*Ndërhyrjet duhet të synojnë nxjerrjen në pah të të gjitha situatave të rrezikut të mundshëm dhe të identifikojnë veprimet korigjuese me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së spitalit, duke marrë parasysh kushtet specifike mjedisore dhe operative në të cilat ato operojnë me pajisjet dhe karakteristikat individuale të projektimit dhe ndërtimit të tij, duke iu referuar periudhës së vendosjes së tyre në treg. Në lidhje me çdo mospërputhje të zbuluar gjatë zbatimit të kontrolleve dhe sipas nivelit të rrezikut të identifikuar, i Kontraktuari do të paraqesë raport të hollësishëm teknik tek Kontraktuesi. Ndërhyrjet e nevojshme do të sigurojnë eliminimin e të gjitha moskonformiteteve të konstatuara në pajisje dhe pjesën e furnizimit të burimit të ushqimit. Këto ndërhyrje janë në ngarkim të të Kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës.*

*Përveç afateve të përcaktuara në kalendarin e verifikimit periodik, shërbimi i verifikimit të sigurisë së përmendura në këtë pikë duhet të parashikohet edhe pas mirëmbajtjes korigjuese, kur është e zbatueshme.*

*Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta.*

*Ofertuesi duhet të lëshojë një deklaratë që merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij gjatë kohës së punës në spital dhe se spitali nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura punonjësve të kompanisë në ambientet e tij.*

*Pjesët përbërëse të sistemit, të këmbimit, përdorimit dhe konsumit.*

*Te gjitha pjesët e këmbimit dhe konsumit janë në ngarkim të të Kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës.*

- Tubi i rrezeve X (blerja dhe instalimi i saj në rast dëmtimi) për pajisjen perkatese.
- Të gjitha pjesët e tjera të këmbimit, të nevojshme për funksionimin sipas standardeve.
- Pajisja UPS e pjisjes
- Të gjitha pjesët e tjera të këmbimi që mund të lindë nevoja të zëvendësohen kur difektohen, me qëllim mirëfunksionimin e pajisjes.

*I Kontraktuari duhet të parashikojë blerjen dhe zëvendësimin e të gjitha pjesëve dhe materialeve të këmbimit gjate kryerjes se shërbimeve me shpenzimet e tij. Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, në përputhje me legjislacionin për pajisjet mjekësore duke siguruar konformitet me*



udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen. Garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti I lëvrimit.

*Shpejtësia dhe shpeshësia e ndërhyrjeve .*

*I Kontraktuari do të duhet të regjistrojë çdo thirrje me qëllim gjurmimin e fillimit dhe mbarimit të çdo ndërhyrje.*

*Njoftimi për defektet do të kryhet me telefon dhe email.*

*Kohëzgjatja maksimale e riparimit të defektit do të jetë jo më shumë se 24 orë kur pajisja nuk ka nevojë për pjesë këmbimi dhe 5 ditë zyrtare pune kur kërkohet zëvendësimi i pjesëve të këmbimit.*

*I Kontraktuari duhet të sigurojë që pajisjet të mos qëndrojnë te difektuara për më shumë se 10 ditë zyrtare pune në vit.*

*Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën, gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës, të përfshijë apo përjashtojë nga shërbimet e përmendura, pajisje të caktuara në funksion të modulit qendror, veprim ndaj të cilit, i Kontraktuari nuk ka të drejtë të kundërshtojë. Ky ndryshim do të rezultojë në rishikimin e kontratës. Vlera e shtuar ose zvogëluar do të llogaritet bazuar në vlerën ditore të mirëmbajtjes për atë pajisje dhe ditëve të përfshirjes në mirëmbajtje. Vlera ditore do të llogaritet bazuar në vlerën vjetore të mirëmbajtjes së asaj pajisjeje.*

#### ➤ TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

“Mirëmbajtja e pajisjeve të mëdha mjekësore “full risk”, Marreveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara- me afat 2 vjecar (24 muaj), me fond limit 8,085,990 (tetë milion e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) Leke pa TVSH”

1	2	4	5	6	7
Nr	Përshkrimi	Njesia	Sasia	Destinacioni	Afati i ekzekutimit
1	Mirëmbajtje Full Risk e pajisjes Skaner Spitali Gjirokastër Toshiba/TSX-021B/4	Muaj	24	SRGJ	24 muaj

Detyrat: **Mirëmbajtja full risk sipas rekomandimeve të prodhuesve përkatës të pajisjes mjekësore që është në përdorim te Spitalit Rajonal Gjirokaster sipas përshkrimit të mëposhtëm të shërbimit.**

Shpërndarja: 24 muaj nga nenshkrimi i marreveshjes kuader.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Spitali Rajonal Gjirokaster, Skaner Toshiba/TSX-021B/4.

Sic është parashikuar në DST sa me sipër cituam në specifikimet teknik dhe termat e referencës qartësisht është kërkuar që OE pjesëmarrës në këtë procedurë duhet ofrojë shërbimin Mirëmbajtja full risk sipas rekomandimeve të prodhuesve përkatës të pajisjes mjekësore që është në përdorim te Spitalit Rajonal Gjirokaster, ky shërbim duhet të kryhet sipas rekomandimeve të prodhuesit, për të parandaluar defektet që lidhen me përdorimin e pajisjeve dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur sistemin e pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të çdo pajisjeje, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetrimi apo përkeqësimi i performancës së pajisjeve etj...,



8

Pra te gjitha sherbimet qe do te ofrohen referuar kerkesave ne specifikimet teknike dhe termat e references sipas objektit te prokurimit jane te lidhura ngushtesisht ne Kompnaine Prodhuese te pajisjes mjekesore objekt prokurimi (Toshiba/TSX-021B/4) dhe sherbimet periodike pergjate gjithë periudhes se sherbimit (24 muaj) duhet te jene sipas rekomandimeve te kompanise prodhuese, e cila i ofron nepermjet kompanive lokale te caktuar nga ata ne cdo vend/shtet nepermjet leshimit te autorizimit nga ana e tyre per caktimin e kompanise distributore ne Shqiperi dhe te autorizuar nga ana e tyre per kryerjen e ketyre sherbimeve sa me siper permendem.

Eshte shume e cuditshme si nga ana e AK nuk eshte parashikuar ne kriteret kualifikuese autorizimi nga kompania prodhuese ose distributori zyrtar ekskluziv i caktuar nga prodhuesi per kryerjen e sherbimeve te kerkuara per kete pajisje objekt prokurimi. Kompania prodhuese nepermjet caktimit te ditributoreve ne vende lokale dhe konkretisht ne Shqiperi autorizon ate kompani per te kryer te gjitha keto sherbime te kerkuara per kete pajisje. Vetem Kompania prodhuese nepermjet caktimit te distriburit ne Shqiperi mund te kryeje keto procedura te sherbimit.

Kompania Prodhuese Toshiba kohet e fundit ka nenshkruar kontrate me kompanine tone per caktimin si distributore zyrtare te autorizuar per rajonin e Shqiperise, cka do te thote qe vetem kompania jone aktualisht mund ti kryeje sherbimet e kerkuara te pajisjes objekt prokurimi si dhe furnizimin me pjese te reja ne raste difektimi.

Mos parashikimi ne DST i kriterit per dokumentin e autorizimit te leshuar nga Kompnia Prodhuese per pajisjen objekt prokurimi i cili eshte kriter shume i domosdoshem dhe i lidhur ngushtesisht me objektin e prokurimit per kryerjen e te gjitha sherbimeve te kerkuara per kete pajisje, eshte bere qellimisht nga ana e autoritetit kontraktor duke cenuar ne menyre te drejtperdrejt ofrimin e ketij sherbimi, menyra e zgjedhur nga ana e AK duke parashikuar kriteret sic eshte ai parashikuar ne piken 2.3.3 ne kapacitetin teknik ne kriteret kualifikuese eshte diskriminuese dhe favorizues per OE te cilet nuk kane te drejte te ofrojne me kete sherbim si dhe gjithashtu ky kriter (pika 2.3.3) sic argumentuam me siper nuk ka asnje lidhje me objektin e prokurimit.

#### **4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkelejt e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

Kerkesa per kualifikim i parashikuara ne DST ne kriteret e vecanta te kualifikimit "Kapaciteti Teknik" Pika 2.3.3 eshte kriter diskriminuese duke favorizuar OE te caktuar, si dhe referuar argumentive sa me siper cituam nuk eshte ne perputhje me objektin e prokurimit, e cial bie ne kundershtim me nenet e parashikuara ne Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik", te ndryshuar.

**Ne nenin 2 te Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", citohet:**

#### **Neni 2 Qëllimi**

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;



P

- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Ne nenin 77 te Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", pika 2 citohet:

Neni 77

### Kërkesat për kualifikim

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

**Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.**

Ne nenin 39 pika 4 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik", te ndryshuar, citohet:

Neni 39

### Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike

4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. **Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.** Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës te cilat duhet te jene te lidhura dhe ne harmoni me objektin e prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit. Autoriteti kontraktor, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specififikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."

Per sa me siper, kerkojme nga ana e AK Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastrer dhe Komisioni i Prokurimit Publik:

- *Heqjen e kriterit per kualifikim te parashikuar ne DST ne kapacitetin teknik ne piken 2.3.3 sa i takon "2.3.3 Operatori ekonomik duhet te kete te pakten nje inxhinier per mirembajtjen e sistemit operativ windows ne nivel MCSE ose ekuivalent te aparatures objekt te ketij prokurimi me profil inxhinier biomjekesor/elektronik", pasi sic argumentuam me siper nuk eshte ne përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, objektin, natyrën dhe vlerën e kontratës.*





**5. Kërkesë për ekspertizë të posacme**

Po

Jo

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)*

---

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

---

---

**7. Lista e informacionit konfidencial:**

---

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes :Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**“DIAL-ALB” Shpk  
Administrator  
Alba KOLA**

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/ Përfaqësuesi i autorizuar**

